

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Enver Peci kryetar kolegji, dhe gjyqtarët Emine Mustafa dhe Nesrin Lushta, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve Sh.G. dhe V.M., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.9 të KPK e lidhur me nenin 31 të KPK, ndërsa i pandehuri V.M. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurve Sh.G. dhe V.M., të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda PPr.nr.59/2017 të datës 13.10.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.1876/2017 të datës 18.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 6.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurve Sh.G. dhe V.M., të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda PPr.nr.59/2017 të datës 13.10.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1876/2017 të datës 18.10.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPr.nr.59/2017 e datës 13.10.2017, të pandehurve Sh.G. dhe V.M., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.9 të KPK e lidhur me nenin 31 të KPK, ndërsa të pandehurit V.M. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, iu ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj e cila do të llogaritet nga data 13.10.2017 deri më datë 13.12.2017. Masa e paraburgimit iu është vazhduar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.3 të KPPK-së.

Me aktvendimin Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN1.nr.1876/2017 e datës 18.10.2017, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve Sh.G. dhe V.M., të paraqitura kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurit Sh.G., av. Sh.A., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nga neni 384 dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën, t'i anulojë aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ate të shkallës së dytë dhe masën e paraburgimit ta abrogojë ose lëndën ta kthejë në rishqyrtim tek Gjykata e Apelit,

- mbrojtësi i të pandehurit V.M., av.V. B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i ndryshojë aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ate të shkallës së dytë, ta hjek masën e paraburgimit ose ta zëvendësoj me ndonjërin nga masat më të buta të parapara me nenin 173 të KPPK.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi të pandehurit V.M., kryesisht thekson se aktvendimet e atakuara janë shumë të ashpëra dhe se gjykata është bazuar në rrethana rënduese, se aplikimi i paraburgimit ka vështirësuar shumë jetën e të pandehurit dhe familjes së tij e cila ka mbetur pa kujdesin e mbajtësit të familjes, se pesha e veprës penale kursesi nuk lidhet me mënyrën ose rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, ndërsa kusht për përsëritjen e veprës penale do të duhet ekzistimi i ndonjë veprë penale i cili është vërtetuar më parë me ndonjë vendim gjyqësor të formës së prerë apo ndonjë dyshim të bazuar por në rastin konkret kjo është hera e parë që i pandehuri V. dyshohet për ndonjë vepër penale.

Mbrojtësi i pandehurit Sh.G., pranë kësaj gjykate ka paraqitur një kërkesë për vlerësim të ligjshmërisë të aktvendimit, e cila i bie në kompetencë të kryetarit të trupit gjykues të gjykatës së shkallës së parë konform dispozitës ligjore të nenit 192 par.2 të KPPK-së, mirëpo për nga përmbajtja e saj shihet se bëhet fjalë për kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, andaj si të till e pranon kjo gjykatë. Në këtë kërkesë mbrojtësi kryesisht thekson se i pandehuri Shemsedin nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë qëllim të kryej një vepër të till penale sepse edhe vet ka qenë hetues dhe ka ndikuar në parandalimin e veprave të tilla, se ai nuk e ka kryer këtë vepër dhe çdo gjë ka qenë pa dijenin e tij, se rreziku i përsëritjes së veprës penale duhet të zbatohet në raste të veprave tjera penale, dhe se caktimi apo vazhdimi i paraburgimit caktohet për tri raste: mundësia e përsëritjes së veprës penale, mundësia e përfundimit të veprës penale dhe mundësia e kryerjes së veprës penale për të cilën është kanosur, e në rastin konkret asnjëra nuk qëndron.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.77/2017 të datës 2.11.2017, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e çështjes, kryesisht nga kallëzimi penal, raportet e policisë, procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit Sh.G., aktvendimi mbi zgjerimin e hetimeve PPI.nr.68/2017 të datës 10.08.2017, si dhe provat tjera të mbledhura gjerë më tani rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 të KPPK për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore, karakteristikat personale të të pandehurve, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, e sidomos fakti se tek të pandehurit është gjetur substanca narkotike e llojit “marihuanë” me peshë 8.606 gram e ndarë në 10 paketime, e gjetur në veturën të cilën e drejtonte i pandehuri Sh., i cili është edhe person zyrtar, ndërsa tek i pandehuri V. është gjetur edhe një pistoletë e markës CZ M-57 të kalibrit 7.62mm me nr.serik 209338, me një karikator me pesë fishek, lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurve në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurve në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.301/2017, më datë 6.11.2017

Bashkëpunatore profesionale
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i gjykatës - kolegjit,
Enver Peci